

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

02.05.2023
Ora 12:35

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.53 me objekt:
kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr . 404,
datë 24.04.2023. Subjekti ankues Partia e Lirisë”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Ledio Braho. Mungon: Z. K. Bele.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PL(A.Kaziaj, F. Guri), PDIU(Sh.Sulo, K. Xhemali)
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE/ODIHR.

Z. E Çefa: Mirdita, të gjithëve! Atëherë do të çelim sot seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr. 53, të depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 24 prill 2023, me kërkues subjektin Partia e Lirisë dhe me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 404, datë 24.04.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e

*Zbardhi materialin audio
Enëida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”; ndryshimin e këtij vendimi, duke caktuar Partinë e Lirisë si parti politike, që i lind e drejta e propozimit të anëtarit të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Sikurse tashmë jeni në dijeni, sepse ne i kemi kaluar këto faza në seancën e vlerësimit paraprak, relatori i kësaj çështjeje do të jem unë, Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën. Është prezent trupa e KAS-it e përbërë nga 4 anëtarë, që do të thotë se për arsye objektive anëtari Bele është sot në pamundësi të marrjes pjesë në këtë seancë, por kjo nuk e pengon KAS-in që të ketë kuorumin e nevojshëm për të shqyrtuar dhe për të marrë vendim lidhur me këtë çështje. Është prezent përfaqësuesi i palës ankuese, është prezent përfaqësuesi i palës së interesuar, i PDIU-së, është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ –së dhe administrata e tij, që në këtë procedim administrativ do të përfaqësojnë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke qenë se nuk kemi asnjë pengesë, fjalën do t’ia jap përfaqësuesit të palës ankuese, zotit Kaziaj, që të parashtrojë edhe një herë shkurtimisht argumentet e tyre dhe kërkimet e tyre lidhur me këtë procedim administrativ. Zoti Kaziaj, fjala për ju.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti relator! Të nderuar anëtarë, siç relatuat edhe ju, kemi të bëjmë me një kërkesë ankimore të ushtruar dhe vënë lëvizje ju nga ana jonë, si subjekt politik nga Partia e Lirisë. Për sa i përket pjesës së objektit të kësaj kërkesë kemi të bëjmë me kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që mban nr. 404, datë 24.04.2023, “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, duke kërkuar nga ana juaj që të shpreheni me vendim, duke ndryshuar vendimin e sipërcituar dhe përcaktuar, në këtë rast, po me vendimmarrjen tuaj, atë që është e drejta e parashikuar në Kodin Elektorale shqiptar në të gjitha ato që ka qenë jurisprudenca e organit epror tuajin dhe organit më të lartë të parashikuar në ligjin zgjedhor, që është Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, duke e përcaktuar Partinë e Lirisë si parti politike, që i lind e drejta për propozimin e anëtarit të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. I nderuar zoti relator, së pari, me vendimin që ankimojmë konstatojmë haptazi që nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit dhe veçanërisht ato të Kodit Zgjedhor, meqë është lënda e tillë. Vendimmarrja e Komisionerit është diskriminuese në këndvështrimin e subjektit që unë përfaqësoj dhe shkelet barazia në garë në vetvete, kjo në kuadër të një fryme, që fare mirë të gjithë ne që merremi me drejtën elektorale, jemi tashmë të qartë, që ka të bëjë me atë që është *ratio* ose qëllimi që të sigurojë baraspeshimin politik. Jo më kot edhe ndryshimet e bëra në Kodin Elektorale në vitin 2020, me ligjin nr. 101/118, ligjvënësi dhe vetë ndërkombëtarët kanë pasur si qëllim kryesor baraspeshimin politik të **armëve** në një garë të caktuar. Në këtë rast flasim për tavolinat e numërimit, që është përmbyllja e një procesi shumë të rëndësishëm, ku fare mirë ju e dini, se keni eksperiencën e mjaftueshme, që ka pasur manipulime të çfarëdolloj natyre në këtë fazë të procesit zgjedhor. Thënë këtë, nuk mundet kurrsesi të barazohen dy subjekte në të njëjtën të drejtë, që kanë peshë të ndryshme elektorale në vetvete dhe politike. Po ashtu flasim këtu për rezultatin e 2017-s, ashtu siç përcakton neni 183, pika 8 e Kodit Zgjedhor, që është dispozita kalimtare, janë 19 mandate për

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksionëve
Dt.02.05.2023*

LSI-së, atëherë PL-në, dhe vetëm 3 mandate për PDIU-në. Të vendosësh shenjën e barazisë midis 2 subjekteve me një peshë kaq të madhe, duke u caktuar me short atyre ndarjen në vetvete dhe hedhjen e shortit për përcaktimin se cilat ZAZ, kush do të marrë tavolinat tek dhe kush do të marrë tavolinat çift, është jo vetëm e padrejtë po, në këndvështrimin tim, joligjore. Së dyti, vendimmarrja e objekt ankimit vjen në kundërshtim flagrant me qëndrimet dhe jurisprudencën konstante, siç e thashë, të Kolegjit Zgjedhor, që është organi juaj epror. Për sa u përket dispozitave të përcaktuara në Kod dhe vendimmarrjes së këtij Kolegji, në shumë vendimmarrje atë të 2015-s dhe 2019-s, që ka saktësuar që kur një subjekt nuk merr pjesë në garë, marrja pjesë në garë nuk do të thotë në vetvete vetëm mos të regjistrojë si subjekt politik, po do të thotë që në 61 bashki, ju e dini fare mirë që PDIU-ja është regjistruar dhe rezulton në fletën e votimit vetëm në një bashki, në Bashkinë e Tiranës, cili është interesi i PDIU –së të ketë përfaqësues në tavolinë numërimi, ndërkohë që në një interpretim (*al contrario*) në të kundërt të vetë Kolegjit Zgjedhor, vetë ky organ gjyqësor suprem i lartë, më i larti, kundrejt të së cilit nuk ka ankim, thotë që në momentin që nuk jeni në garë, nuk ka se si të interesoheni për garën, po e them me fjalë të thjeshta. Kështu që nuk e kuptoj sepse PDIU-ja rezulton në një fletë votimi dhe të ketë numërues në çdo bashki të këtyre zgjedhjeve, pra në 60 bashkitë e tjera ku s'ka kandidatë. Kjo gjë do të duhet që ju me interpretimin që do t'i bëni ligjit, me jurisprudencën që do të jepni, shoh që zoti Bele sot nuk është, por gjithsesi kemi kuorumin e mjaftueshëm për të vendosur me vendim, mendoj që ju do të duhet ta analizoni në germë dhe në frymë mospasjen e PDIU –se në garë dhe kërkesën e saj të padrejtë, të paligjshme për të pasur persona të ngarkuar me detyra zgjedhore, ndërkohë që s'ka interes të ligjshëm për t'i pasur,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

se çfarë do të numërojnë, se çfarë do të garantojnë këta persona tek ky subjekt, kur vetë ky subjekt nuk garon. Po ashtu ky subjekt garon vetëm, në qoftë se nuk gabohem në këtë rast, vetëm në 53 këshilla bashkiakë dhe aty është në ecedim të një të drejtë të vetë. Nuk ka sesi të kërkojë në 100% të atyre që janë baskitë, për cilën do të shkojmë në votë, të kërkojë persona me detyra zgjedhore, ndërkohë që subjekti që unë përfaqësoj, është një subjekt që garon në fletën e votimit në 61 bashki për kryetar bashkie normalisht dhe garon në fletën e votimit për 61 bashki për këshilltarë bashkiakë. Kemi 2 subjekte politike, që kanë marrë anëtarë në këtë rast, ndërkohë që subjekti, nga interpretimi që i bëhet vendimit, të themi të 2019-s, PD-ja dhe LSI-ja i janë drejtuar Kolegjit duke konsoliduar një praktikë të tillë Kolegji, siç jua thashë, në fund të së cilës shprehet tekstualisht: “Në kuptim të nenit 145 partitë politike legjitimohen t’i drejtohen Kolegjit Zgjedhor duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vetëm në rastet kur është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor”. Duke e marrë këtë në interpretim në të kundërt, siç thashë, në rastin konkret, thotë Kolegji, partitë politike, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, nuk kanë paraqitur kërkesë për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një parti që s’ka paraqitur kandidatë dhe është paralelizëm i pastër. Megjithatë, kanë kaluar të gjithë afatet, thotë, të parashikuara në Kodin Zgjedhor për t’u regjistruar si të tilla. Për pasojë, në kushtet e rrethanat konkrete subjektet politike, palë paditëse në këtë gjykim, nuk gëzojnë legjitimitetin aktiv për të kundërshtuar vendimmarrjen ose veprimtarinë e palës së paditur, që është KQZ-ja. Kështu që mendoj që nuk gëzon as subjekti një drejtë të tillë për të ushtruar një subjektivitet të kësaj natyre për të çuar deri në këtë fazë atë që është një

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 02.05.2023*

vendimmarrje që tashmë duhet të jetë, të paktën, e mbyllur se këta numërues në 100% të këtyre bashkive, pra, në 61 bashki, do të duhet t'i jepeshin subjektit që unë përfaqësoj, pra Partisë së Lirisë. Kemi të bëjmë, fatkeqësisht, me një vendimmarrje të Komisionerit Celibashi, i cili nuk merr në konsideratë faktet dhe argumentet nga ana jonë, vendimmarrje që ne e kemi sjellë përpara jush. Në interpretimin sistematik, të themi, të asaj që është dispozita ose të asaj që është vendimmarrja, që mban numrin 10, datë 06.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor shprehet për një interes të ligjshëm. Pra, duke mbuluar kështu edhe pjesëmarrjen, edhe regjistrimin në të gjitha nivelet e KQZ –së, thënë ndryshe, duke filluar kështu nga paraqitja e kandidaturave, të kandidatëve për kryetar bashkie, të 61 bashkive apo të gjithë atyre që janë kandidatë që janë për këshilltarë bashkiakë. Në atë që është edhe vetë parashikimi zgjedhor, për sa i përket pjesës, siç e thashë, nenit 183 /8 dhe në interpretimin logjik, nga e kundërta, rezulton se anëtarë të ZAZ-së, KQV-së dhe GNV-së mund të propozohen vetëm partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje, duke shtuar me ndryshimet e vitit 2020, se përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 në konfigurimin shumicë-pakicë në Kuvendin, në çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Komisioneri Celibashi, në qoftë se ju e keni në brendësi të dosjes suaj, që besoj se po, i ka bërë një shkesë Kryetares së Kuvendit, duke i kërkuar në vetvete se cili është konstituimi i shumicë-pakicës. Ka ardhur një përgjigje kuazi, jo përgjigje nga ana e Kryetares së Kuvendit, po bashkë më të ka ardhur edhe dokumentacion shtesë. Çfarë dua të them? Ne kemi 2 deklarata, të paktën, të atyre që pretendojnë se janë zgjedhur nga PDIU-ja, flasim për një deklaratë të bërë në mbështetje të nenit 15, të Rregullores së Kuvendit, të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

zonjës Reme Lala, e cila deklaron se është e pavarur. Kemi një deklaratë tjetër të zonjës Selena Xhili, e cila deklaron që nuk bëj pjesë në asnjë grup dhe jam e pavarur. Tani ju do të duhet t'i analizoni fare mirë këto gjëra, se ligji e parashikon shumë qartë, që e drejta për të pasur numërues lind kur ka 2 ose më shumë deputetë, ndërkohë që deputetët e tjerë nuk na i kanë venë në dispozicion se si janë konstituuar në çeljen e vet, të themi, të asaj që është legjislatura e vitit 2017. Ndërkohë që shohim 2 raste besoj, nga 3 që thonë se janë të pavarur. Kështu që duhet ta analizoni me shumë kujdes këtë fakt, për shkak se vetë ata janë zgjedhur në siglën e PDIU-së, ndërkohë në konstituimin e Kuvendit vetë garantojnë, nën përgjegjësinë e tyre, që nuk bëjnë pjesë në këtë parti, pra, janë të pavarur. Ju tashmë i dini fare mirë qëndrimet që ka mbajtur subjekti politik PDIU, e dini fare mirë që është sqaruar, ka mbajtur një anë të tillë me deklarata publike dhe me votime të shumta në Kuvendin e Shqipërisë, për sa i përket pjesës së vendimmarrjeve që ka pasur ky Kuvend me iniciativë të qeverisë. Pra, është një koncept i përgjithshëm, që opozita do të duhet të bëjë oponencë jo atëherë kur ligjet duhen të kalojnë në të mirë të qytetarëve të saj, por jo ligje të natyrës abuzive, siç po bën kjo qeverisje dhe PDIU-ja çfarë ka bërë? Ka ngritur kartonin jeshil në 90% të rasteve të atyre ligjeve. Ju e keni edhe me një shkresë të Kuvendit këtë gjë dhe mund ta verifikoni vetë, duke mos i dhënë një përgjigje shteruese asaj që është kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kryetarja të Kuvendit në një shkresë që mban datën 20.04.2023, thotë se, Kuvendi i Shqipërisë nuk disponon deklaratimet e deputetëve për përfaqësimin e tyre partiak. Kjo nuk është e vërtetë, sa ju dhashë 2 shembuj që thonë se janë të pavarur. Keni me qindra shembuj të tillë të sjella po nga Kryetarja e Kuvendit, që thonë i përkasin x subjekti

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

politik. Shkresa e dytë ka të bëjë me një pyetje të bërë nga ana Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, lidhur me këtë që sapo thashë me votimin, pra qëndrimet zyrtare që kanë mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë ata që janë zgjedhur në siglën e PDIU-së, që më vonë normalisht sipas interesit të tyre, janë deklaruar të pavarur dhe thotë se informacioni në lidhje me mënyrën e votimit të deputetëve në seancën plenare është publik dhe mund ta gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit, në adresën vijuese. Pra, paska qenë kaq e vështirë për Kryetaren e Kuvendit, siç duket nuk ka pasur kohë, ka qenë edhe ajo në fushatë zgjedhore, saqë një rëndësie kaq të posaçme, sa ka ky moment i procedurës së Kodit Elektorale dhe një kërkesë të bërë nga ai që e përfaqëson këtë institucion, zoti Celibashi, bashkë me ju, normalisht, nuk ka dashur t'i vërë në dispozicion të gjitha statistikat lidhur me votimin që ka pasur në Kuvendin e Shqipërisë për zotërinjtë, kuvendarët e PDIU-së. Ndërkohë që ne me iniciativë i kemi tërhequr dhe shohim, pro, pro, pro, në çdo projektligj, në çdo ligj, në 90% të rasteve. Tani si mundet të quhet parti e opozitës një parti e zgjedhur, ose disa deputetë të zgjedhur për të mbrojtur interesin e zgjedhësve të vet, për të mbrojtur interesin e opozitës, e cila siç e thashë edhe më përpara, duhet të bëjë oponencë kundrejt të gjithë atyre iniciativave me karakter abuzues, që kjo qeveri ka bërë me ligj dhe ka ngritur kartonin për interesa karakterit personal. Nuk mundet, as logjika më e ulët nuk mund ta pranojë këtë gjë. Siç e thashë, interes të madh ka dhe baraspeshimi politik, gjë duhet të jetë në vëmendjen tuaj të posaçme, për shkak se lënia e fushës së lirë të një qeveri që ka rreth 99% të pushtetit, të çdo lloj pushteti në Shqipëri, e menaxhon, e urdhëron, e koordinon dhe e vë në funksion të vetë zgjedhjeve; ju jeni qytetarë të këtij vendi dhe e shihni në përditshmëri se çfarë po bëhet, kanë filluar po plasin rrugët nga shtrimi elektorale,

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

po bëhen veprimtari të karakterit publik nga të katër anët e Shqipërisë. Nuk shohim, po marr një shembull, një fotografi, një poster ose një banderolë të zotërisë që është kryetar i Bashkisë së Tiranës, po shohim të atij zotërisë që banon në Surrel. Në çdo vend të Shqipërisë, ai zotëria sikur po kandidon për kryetar bashkie, fotoja e tij sikur është ndonjë kandidat. Shkon në Tepelenë dhe është fotoja e tij, s'është fotoja e kryetarit të Bashkisë së Tepelenës, është fotoja e tij, vjen në Tiranë fotoja e tij, shkon në Shkodër po ashtu. Pra, vënia në dispozicion e makinerisë shtetërore, në këtë rast, nuk është se është pa logjikë dhe të gjitha pushtetet që kanë në dorë zotërinjtë po i vënë duke cenuar dhe opozitën në atë që kanë qenë vetë një dakordësi politike e menaxhuar dhe koordinuar nga ndërkombëtarët për të arritur ndryshimet e ligjit me ligjet nr. 101 dhe 118. Në këtë rast ne mendojmë që ka argumente të mjaftueshme që ju, si komision epror, për të zhbërë atë që ka qenë një vendimmarrje kryekëput në kundërshtim me ligjin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ka të bëjë me vendimin numër 404 të tij, do të duhet ta ndryshoni atë vendim duke caktuar Partinë e Lirisë, në këtë rast, si partinë politike që i lind e drejta për të propozuar anëtarin e 4 të grupit të numërimit të votave për zgjedhjet e organit të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit shumë!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, zoti Kaziaj! Tani proceduralisht i takon KQZ-së të argumentojë qëndrimin e saj dhe më pas do t'ia japim fjalën personit të interesuar PDIU. Si mendoni zoti Merkaj apo do t'ia cedoni ju të drejtën që të flasë përpara. Dakord. Atëherë, përfaqësuesi i PDIU.

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. I. Sefa: Po, faleminderit zoti relator! Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve Zgjedhore, unë këtij komisioni nuk do t'i marr shumë kohë, siç bëri parafolësi, pak a shumë jemi të gjithë juristë dhe në këtë trupë zgjedhore mendoj se do të kenë më shumë vend argumentet ligjore apo në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe jo për të bërë politikë apo show. E dëgjoj shpesh në këtë komision parafolësin që është shumë i shqetësuar, që këtu vijnë ankime, apo këtu vijnë procedura, apo bëhen pretendime nga përfaqësues të partive, subjekte zgjedhore, dhe po i hanë shumë kohë këtij komisioni e kësaj trupe kur fare mirë mund të ngrenë vetë pretendimet e shkeljeve, të cilat unë jam shumë dakord që po bën pozita apo qeveria ku unë kisha shprehjen që ato posterat vetëm tek dera e shtëpisë nuk na i kanë vendosur. Megjithatë unë do t'ia lë emocioneve që përcjell gjithmonë kolegu, për shkak se ka marrë përsipër edhe mbrojtjen e një subjekti politik shumë historik në Shqipëri. Ndodhemi përpara këtij komisioni për të shprehur pranimin apo mospranimin e ankimit të subjektit: LSI apo Partia e Lirisë dhe lënien në fuqi të vendimit numër 404 i datës 24.04.2023 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka të bëjë me caktimin e partive politike. Duke lexuar ankimin vërejmë jo argumente ligjore, por thjesht citime politike apo fraza, të cilat, po t'i referohesh ligjit, nuk kanë lidhje fare me ankimin e bërë, si për shembull: vendimmarrja e komisionit është diskriminuese dhe shkel barazinë në garë. Ko për fakt se nuk ka baraspeshim politik në çdo nivel pra barazia e peshës elektorale dhe dy forcave politike. KQZ-ja nuk duhet të bazohet vetëm në renditjen e subjekteve zgjedhore maxhorancë apo opozitë, por në kohën reale pra në kohën dhe momentin që do të

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

bëhet shpërndarja e anëtarëve të KQZ pra sot. PDIU ka kaluar në zgjedhjet e mëparshme si pjesë e opozitës, por kohët e fundit ka votuar mjaft nisma të qeverisë. KQZ nuk ka marrë në konsideratë rezultatin politik të momentit që disa subjekte të marrin anëtarin e GNV-ve, kur nuk kanë mundësinë të gjejnë kandidatë në të gjithë vendin. Ndërkohë, neve, si subjekt garues na bëhet një dëm i madh në këto zgjedhje dhe padrejtësi flagrante, diskriminim. Kjo pasi jo vetëm publikisht ne përfaqësojmë opozitën reale, llogarit LSI, është opozita reale, është e djathta reale, por jemi 3 subjekte të vetme që garojmë në 67 bashki. Votat tona kush do t'i numërojë dhe mbrojë në këtë rast PS apo subjekte të tjera zgjedhore që filtrojnë me maxhorancën absurde dhe hiqen sikur janë pjesë opozitës kur i kërkon interesi? - shton ankuesi. Sinqerisht të nderuar anëtarë, unë personalisht, ndjehem shumë i thjeshtë pasi komunikimi është një çështje pasi përpara ka një trupë të përgatitur me avokatë me persona që e njohin jashtëzakonisht mirë Kodin Zgjedhor.

Z. A. Kaziaj: Ju lutem, mos ushtroni ndikim tek trupa, trupa është e paanshme.

Z. I. Sefa: Të lutem, a mund të flas? Unë i kuptoj emocionet po të paktën për respekt, si dhe përpara është dhe profesori im nuk e di zotërisë i ka dhënë mësim apo jo.

Z. A. Kaziaj: Ju lutem, kjo është e tepërt, profesori juaj ka një pozitë publike dhe të shprehet për vendimin.

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. I. Sefa: Për caktimin partive politike që do të marrin pjesë në short që në bazë të rezultatit të tij do të fitojnë të drejtën të propozojnë anëtarin e 3 dhe të 4 të numërimit të votave në ZAZ Komisioneri bazohet në përcaktimet e Kodit Zgjedhor. Referuar vendimit 555 datë 26.7.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtarë të zgjedhjeve datës 25 qershor 2017, PS: 74, PD: 43, LSI: 19, PDIU: 3 dhe PSD: 1. Partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZA-së Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Partitë Politike që nxjerrin jo më pak se 2 mandate përveç partive partive propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin janë Partia LSI dhe PDIU. Referuar nenit 2 dhe paragrafit 2 dhe 3 të udhëzimit Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 5 datë 16.03.2021 për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e 3 dhe të 4 të GNV-ve, partitë e shumicës parlamentare, Partia Social Demokrate nuk e përmbushi kriterin dhe është e vetmja parti, pra ajo çka u përcaktuar dhe pak më parë nga parafolësi. Nga partitë e opozitës parlamentare LSI dhe PDIU përmbushin kriterin e numërimit të mandateve dhe iu lind e drejta të bëhen pjesë e shortit të caktuar për të caktuar anëtarin e 4 GNV-së. Në parlamentin e Shqipërisë dalë nga zgjedhjet e 2017 janë votuar edhe ndryshimet e Kodit Zgjedhor mbi bazën e cilës do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore dhe është rënë dakord midis të tjerash edhe për disa çështje, të cilat do të rregulloheshin kjo është shumë e rëndësishme me anë të dispozitave kalimtare, siç janë përcaktuar saktësisht në nenin 183 të këtij Kodi, me titull “Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe të

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 02.05.2023*

administratës zgjedhore” në pikën 8 të caktohet konciz në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet para vendore pas hyrjes së këtij ligji dhe e 3 e propozimit të anëtarëve të KZAZ-së, KQV-së dhe GNV-së të përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfirmimit shumicë pakicë të Kuvendit, me çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Në referim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor, i cili përcakton si moment me të cilin duhet vlerësuar përkatësia në partitë e shumicës, apo të pakicës, apo të opozitës parlamentare, nuk është pozicioni faktik që zënë këto parti në moment të caktuar, siç u citua pak më parë, por pozicioni që kanë këto parti në zgjedhjet parlamentare pararendëse në Kuvendin e Shqipërisë. Referuar zgjedhjeve të 2017 PDIU-ja është parti parlamentare dhe ka dalë nga opozita e partive të opozitës. Brenda afatit ligjor, siç dihet, PDIU është regjistruar si subjekt zgjedhor i vetëm për zgjedhjet e 14 majit 2023. Theksojmë para këtij komisioni se në vitin 2017 PDIU ka nënshkruar marrëveshje me PD dhe doli në zgjedhje si forcë opozitare. Fakt tashmë i njohur publikisht nga të gjitha portalet. Në çdo portal është theksuar se kryetari i PDIU-së angazhohet për të përmbyllur marrëveshjen me opozitën parlamentare. Jemi munduar të nderuar për t’i nxjerrë dhe për t’i paraqitur pranë këtij Komisioni, por, po t’i referohesh asaj periudhe, realisht në maxhorancë të asaj kohe dihet fare qartë se kryetari i atëhershëm i LSI u bë President i Shqipërisë. Fakt shumë i njohur. Sot faktikisht meqë po flasim për diskriminimin, 4 deputetë kanë ata, 4 deputetë kemi ne. Nëse në këtë komision vlerësohet se kush është më i bukur ata apo tanët është puna juaj. Theksoj se 1 deputet i tyre u largua me maxhorancën po në këtë mandat. Në çfarë neni apo ligji të Kodit Zgjedhor vendime të KQZ apo manuale, të cilat rregullojnë zgjedhjet është e përcaktuar

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

detyrimi për partitë politike si duhet të dalin në zgjedhje në të gjitha zonat zgjedhore apo jo? Po t'i referohesh tashmë nenit 15, pika 5 e Rregullores së Kuvendit aty thuhet se brenda 5 ditëve nga marrja e mandatit çdo deputet cakton s enë çfarë grupi parlamentar bën pjesë. Po kështu, referuar nenit 15 të Rregullores së Kuvendit thuhet se “deklarimi i pozicionit politik i grupeve parlamentare”. A ka deklarime të tilla nga deputetë të PDIU-së, sot në parlament në mbështetje të maxhorancës?

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, zoti relator, ju lutem a mund, të mbaroj unë tani?

Z. E. Çefa: Zoti Kaziaj, ju lutem edhe një herë, jua krijuam mundësinë që ju të flisni pa u ndërprerë! Zoti avokat, një sekondë se do t'jua jap unë fjalën pasi të qetësoheni pak të dyja palët. Zoti Kaziaj, ju lutem ju e patët mundësinë të flisni pa u ndërprerë, krijojeni edhe kolegut të njëjtën hapësirë.

Z. A. Kaziaj: Ju lutem, zoti Çefa, duhet t'i tërhiqni vëmendjen, në komision duhet të flasim me etikë!

(Diskutime pa mikrofon)

Njeriu është i madh sa etika që ka, nëse nuk ka etikë...

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. E. Çefa: Atëherë, do t'ju lutem të dyja palëve të ruani pak gjakftohtësinë dhe etikën në këtë sallë!

Z. I. Sefa: Është radha ime për të folur.

Z. E. Çefa: Patjetër e keni ju radhën dhe unë po ju lejoj të vazhdoni.

Z. I. Sefa: Çfarë ka votuar PDIU-ja në parlament? Çdo marrëveshje me partnerët ndërkombëtarë në të mirën e popullit shqiptar; çdo marrëveshje që është në dobi të kombit shqiptar, marrëveshjen për eliminimin e taksimit të dyfishtë në një vend të BE-së e cila është direktivë e BE-së e cila shërben që një biznes të mos taksohet dy herë, kur dihet se LSI dhe forcat e tjera kanë votuar me dhjetëra pavarësisht se në këtë votim nuk kanë qenë prezent. Pra, cili është votimi që thuhet në këtë ankim që është në mbështetje të maxhorancës? Kolegu e di shumë mirë se është avokat që barra e provës për të sjelle e ka zotëria nuk e kam unë. Thuhet çfarë do të numërosh në grupet e numërimit. Referuar përvojës sime në KZ, për 25 vjet, duke filluar nga vëzhgues anëtar, anëtar i grupit të numërimit, kryetar i KZZ-ve, punonjës në KQZ-, ekspert në komisionin parlamentar, ekspert në komisionin e posaçëm zgjedhor, si përfaqësues i opozitës, nuk ndodh të thuhet çfarë do të numërojë një anëtarë i grupit të numërimit. Kuptimi i fjalës numërues në Kodin Zgjedhor është fare i qartë termin rolin dhe qëllimin e tij, numëruesi nuk është as i kuq, as blu, as biond, por është shtetas shqiptar, i cili përmbush kriteret sipas kodit

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

dhe ligjit që të kryejë numërimin e votave vetëm në respekt të ligjit, si për ata që e kanë propozuar, por edhe për të gjitha fletët e votimit dhe për të gjithë anëtarët që ndodhen në këtë fletë votimi dhe në atë tavolinë numërimi ku bën pjesë. Pra, unë e konsideroj numëruesin si një person që përveç votave të subjektit që është propozuar në ligj numëron me përgjegjësi ligjore çdo votë që gjendet në kuti për të gjitha subjektet zgjedhore të cilat ndodhen në fletën e votimit. Po çfarë votash do të numërojë? Ishte një nga argumentet e ngritura dhe pyetjet që bëhen nga ankuesi? Votat e kandidatëve shqiptarë me integritet dhe që e duan vendin e tyre, që punojnë për të, votat e kandidatëve që duan Shqipërinë dhe jo për ata që përdhosin simbolet e shtetit shqiptar. Lind pyetja për se në proceset zgjedhore subjekte të caktuara zgjedhore dhe posaçërisht LSI, nuk e do PDIU-në me anëtarët e tyre në Komisionet Zgjedhore, edhe pse këtë të drejtë ia jep ligji? Më duhet të sjell në vëmendje të këtij komisioni të nderuar, se sipas faqes zyrtare të parlamentit shqiptar thuhet se PDIU, parti politike në Shqipëri ku qëllim primar është promovimi i çështjes kombëtare të shqiptarëve duke përfshirë edhe Kosovën, shqiptarët e Malit të Zi, Preshevës dhe sidomos çështjen çame. Një padrejtësi e tillë i është bërë kësaj force politike edhe më parë, shkelje e cila është e përfshirë në raportet e OSBE-ODIHR-it. Pa u zgjatur, të nderuar anëtarë, i nderuar relator, KQZ apo çdo strukturë e saj konkretisht KAS-i në vendimmarrjen e tij i referohet ligjit dhe absolutisht qëndrimeve politike, në bazë të Kodit Zgjedhor dhe çfarë parashtruar më sipër kërkojmë mospranimin e këtij ankimit të pambështetur në prova në ligj, si dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 404, 24.04.2023 të Komisionit Qendror Të Zgjedhjeve për sa i përket caktimit të partive politike të propozojnë

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

anëtarin e katërt të numërimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju Faleminderit! Po, zoti Kaziaj.

Z. A. Kaziaj: Vetëm një gjë të vogël kam, i nderuar zoti relator. Fakti është se ne jetojmë në një vend demokratik, ku harmonia e këndvështrimeve fetare ose e çfarëdolloj natyre apo edhe e prejardhjes në vetvete është e tillë që na veçon nga popujt e tjerë, por në veçanti të dëgjosh përfaqësuesin e PDIU-së që do të numërojë votat e PBDNJ-së kjo me duket e çuditshme nga platformat politike që kanë dy subjekte politike.

Z. E. Çefa: Do t'jua jap fjalën patjetër, sepse ju takon, por do t'ju lutem të dyja palëve konsiderojeni këtë komision kuazi gjykatë. Pra, ndryshon seanca publike përpara Komisionerit, ku ju mund t'ia lejoni vetes edhe pak ngjyrim të atmosferës dhe ndryshon seanca në KAS, ku do t'ju kërkoj me shumë mirësjellje dhe me shumë mirënjohje që t'i referoheni vetëm ligjeve, dhe të lini mënjanë komentet.

Z. I. Sefa: Faleminderit, i nderuar relator, unë personalisht këtë, që ju e thatë tashmë, e shpreha që në fillim të parashtrimit tim në lidhje me ankimin e bërë. Unë i rendita të gjitha argumentet ligjore dhe unë nuk përmenda ndonjë forcë

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

politike, por unë jam i detyruar që çdo pretendim i ngritur në ankim se cilat vota do të numërosh unë përmenda do të numëroj votat e të gjithë shqiptarëve që duan Shqipërinë dhe i shërbejnë shqiptarëve në organet e qeverisjes vendore. Kjo është ajo që thashë, prandaj unë e thashë atë që ndjehem i lehtësuar, sepse ndodhem para një trupe juristësh dhe e konsideroj veten sikur jam para një gjykate.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë përfaqësuesi i KQZ-së, zoti Sekretar i Përgjithshëm shkurtimisht për vendimin e Komisionerit dhe për qëndrimin tuaj lidhur me ankimin.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Neni 96, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon që partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë e të katërt të grupeve të numërimit përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktojnë pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Referuar nenit 183, pika 8, të Kodit Zgjedhor, që është te dispozita kalimtare, parashikohet që në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta e propozimit të anëtarit të KQV-ve dhe anëtarëve të grupit të numërimit përcaktohet sipas rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimi shumicë-pakicë të Kuvendit me çeljen menjëherë të tij pas këtyre zgjedhjeve. Me vendimin

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

nr. 555 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vitit 2017 është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 të Kuvendit të Shqipërisë dhe numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë: Partia Socialiste 74 mandate, Partia Demokratike 43 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim 19 mandate, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 3 mandate dhe Partia Socialdemokrate e Shqipërisë 1 mandat. Referuar këtij vendimi dhe neneve 96 dhe 183 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri ka vendosur që nga partitë politike të shumicës parlamentare Partia Socialdemokrate nuk përmbush këtë kriter dhe anëtarin e tretë të grupet e numërimit do ta propozojë Partia Socialiste, ndërsa nga partitë e opozitës parlamentare Partia e Lirisë ose ish-Partia e Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet përmbushin numrin e mandateve që u lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të grupeve të numërimit. Referuar kësaj dispozite, është hedhur edhe shorti dhe janë caktuar këto dy parti për të propozuar anëtarin e katërt të grupeve të numërimit.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Pyetje nga kolegët.

Z. I. Rusmali: Unë kisha dy pyetje për zotin Kaziaj. Ju nxorët këtu, besoj se do të na i jepni t'i administrojmë si prova, dy deklarata deputetësh, të cilët deklarohen si deputetë të pavarur mbas zgjedhjeve të vitit 2017. Besoj e kuptova drejt.

Z. A. Kaziaj: Po.

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. I. Rusmali: Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm thotë që pas zgjedhjeve të vitit 2017 pala e interesuar ka pasur 3 mandate të dala nga këto zgjedhje. Këtë statistikë ju nuk e kontestoni, apo e kontestoni?

Z. A. Kaziaj: I nderuar, zoti Rusmali, siç thatë edhe ju, ne kemi këtu një deklaratë personale të atyre që janë zgjedhur nën siglën e PDIU-së, por cili është momenti, do të thosha unë, që të quhet, të arrihet kuorumi i mjaftueshëm i parashikuar në ligjin zgjedhor lidhur me dy ose më shumë mandate? Kush e vërteton këtë, partia politike? Subjekti politik, apo vetë përfaqësuesi i atij subjekti? Pra, që është deputet i Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, siç ju thashë, ju lexova edhe dy emra. Në qoftë se në vitin 2017 PDIU-ja ka pasur 3 deputetë, dy nga tre deputetët thonë që nuk bëjmë pjesë në asnjë grup politik e jemi të pavarur. Më falni pak, 3-2=1. A e përmbush kushtin?

Z. I. Rusmali: Kjo ishte pyetja që kisha unë: A e përmbush kushtin?

Z. A. Kaziaj: Sipas nesh, nuk e përmbush kushtin.

Z. I. Rusmali: Sepse deklarimi personal i tyre rrëzon kriterin për dy mandate të dala nga kjo parti. Pyetja e dytë: Ju thatë në shtjellimet tuaja, e keni edhe me shkrim, se për shkak se pala e interesuar nuk ka kandidatë në të gjithë Shqipërinë,

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*


nuk i takon të ketë numërues në të gjithë Shqipërinë ose të marrë pjesë në këtë numërim, sepse nuk mund të numërojnë atje ku nuk ka votat e veta. Po e perifrazoj. Një situatë të ngjashme e ka edhe Partia Demokratike. Do të thotë kjo që edhe Partisë Demokratike duhet t'i hiqen përkatësisht komisionerët ose numëruesit?

Z. A. Kaziqaj: I nderuar zoti Rusmali, për baraspeshim, paralelizmi që ju morët është i drejtë. Fakti është që në këndvështrimin tim dhe si e lexoj unë ligjin në vetvete, ngarkimi i personave me detyra zgjedhore, jo më kot ligjvënësi e ka parashikuar që këta persona të jenë politikë, jo të numërojnë votat e shqiptarëve. Normalisht votat e shqiptarëve do të numërojnë, do të kenë përgjegjësinë penale, civile, profesionale, qytetare, çfarë të doni ju, që të numërojnë votat e shqiptarëve, por jo më kot ligjvënësi ka parashikuar që këta persona të kenë karakter politik dhe të propozohen nga një subjekt politik. Pyetja e bërë nga ana juaj sipas meje qëndron në vetvete, është e saktë.

Z. I. Rusmali: Domethënë edhe Partisë Demokratike duhet t'i heqin numëruesit, eventualisht komisionerët.

Z. A. Kaziqaj: Në këndvështrimin tim, në qoftë se interesat e një subjekti në vetvete në rang, po flasim për zgjedhjet vendore në këtë rast, nuk mbulohen 61 bashkitë e vendit, por që janë tre subjekte që garojnë në 61 bashkitë e vendit, del dhe nuk përmbushet sensi i ligjvënësit në vetvete që ka ngarkuar një subjekt me detyra

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

zgjedhore për të propozuar emrat e atyre që do të mbrojnë interesa të votës, por edhe të subjektit në vetvete.

Z. I. Rusmali: Në qoftë se unë e përkthej drejt këtë që sapo thatë ju, ju jeni i mendimit që edhe Partisë Demokratike t'i hiqen numëruesit, eventualisht komisionerët atje ku nuk ka kandidatë në maxhoritar.

Z. A. Kaziqaj: Për ta filluar nga e para. Ju më bërë dy pyetje. Sipas meje janë kushte kumulative, pavarësisht se pyetjes së dytë iu përgjigja.

Z. I. Rusmali: Me një po ose jo që të jemi të qartë.

Z. A. Kaziqaj: Jua qartësoj unë, se nuk kemi qëndrimet e herës së fundit për sa i përket pjesës së shkarkimit të kryetarëve të partisë, por kemi të bëjmë me dy pyetje të bërë nga ana juaj. Sipas meje janë kushte kumulative dhe ju falënderoj për pyetjet që bëtë për shkak se deklarata që thotë nuk i përkas asnjë grupi dhe jam i pavarur përbën sens dhe ligj dhe në vetvete mospërbushja e interesit të partisë duke garuar në 61 bashki përbën sens e ligj. Partia Demokratike në këtë rast ka deputetë të zgjedhur që i përkasin këtij grupi parlamentar dhe kësaj partie, nuk kanë dalë të pavarur, pra e përmbush kushtin e dy ose më shumë mandateve. Kjo është e vetmja diferencë, i nderuar zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Do të thotë që duhet të jenë të dyja kushtet bashkë që të funksionojë mekanizmi. Në qoftë se është njëri nga kushtet, humbet e drejta.

*Zbardhi materialin audio
Enëida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. A. Kaziaj: Në këndvështrimin tim po, por fakti është që duhet pasur një jurisprudencë të konsoliduar, mbase të Kolegjit, për të arritur në një qëndrim unifikues.

Z. I. Rusmali: E qartë.

Z. E. Çefa: Po, zoti Braho.

Z. L. Braho: Unë do të bëj pyetjen, por nuk e di se kush mund të më kthejë përgjigje. Zoti Kaziaj, ju citoni këto dy deklaratat nga dy deputetë dhe thoni që janë 3 deputetë që kanë dalë me siglën e PDIU-së në vitin 2017. Po deputeti i tretë, mund ta kemi informacionin si është deklaruar? Ka qenë pjesë e ndonjë grupi parlamentar të opozitës, pozitës?

Z. A. Kaziaj: Zoti Braho, faleminderit, për pyetjen! E lidh këtë qëndrim edhe me atë që është parashikim i pikës 8 të nenit 183 të dispozitës kalimtare. Pak më parë Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së tha që në vitin 2017 në konsituimin sipas asaj që parashikon pika 8 e nenit 183, nën siglën e PDIU-së ishin tre deputetë. Pra konstituimi është një moment fillestar. Deklarata është një qëndrim personal, pavarësisht se ju zgjidheni nga një subjekt dhe garoni për atë subjekt, në rastin kur ju merrni mandatin, ata kanë deklaruar që ne nuk i përkasin këtij subjekti dhe nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar.

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. L. Braho: Ata të dy i kuptova, po për të tretin keni informacion?

Z. A. Kaziaj: Nuk keni informacion për shkak se këtë informacion na e ka sjellë me shkresë përcjellëse duke iu përgjigjur Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vetë Kryetarja e Kuvendit dhe ka mungesë të theksuar dokumentacioni nga seleksioni i të gjitha qëndrimeve të mbajtura në Parlament, kemi arritur të gjejmë këto dy qëndrime. Për të tretin do t'i lutesha KQZ-së nëse ka ndonjë informacion më tepër.

Z. L. Braho: Mund të na i vini në dispozicion, zoti Merkaj, se nuk e kemi këtë praktikën e Kuvendit.

Z. Y. Merkaj: Praktikën e Kuvendit jua vë unë në dispozicion.

Z. L. Braho: Ju keni informacion për deputetin e tretë?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. E. Çefa: Kishte një prapësim.

Z. Sh. Sulo: Në lidhje me pyetjen që bëri anëtari i KAS-it për mandatet e PDIU-së për vitin 2017, nga cili subjekt dalin mandatet është përcaktuar me vendimin e KQZ-së, që janë tre mandate. Si janë deklaruar në bazë të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, e nxjerr Kuvendi dhe në fakt Kuvendi ka sjell shkresën që na është

*Zbardhi materialin audio
Enelda Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

vënë në dispozicion, janë të gjitha deklaratimet e 140 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. A nuk i kanë lexuar, a i kanë lexuar, a duan t'i nxjerrin kështu, është histori tjetër. Qenia ose mosqenia në një grup parlamentar nuk të bën pozitar dhe fakti që janë të pavarur nuk do të thotë që janë pozitarë, në qoftë se doni të insinuooni këtë gjë, kanë për qëllim që të kuptojnë këtë gjë. Pra, kjo ishte për sqarim.

Z. E. Çefa: Po, zoti Lako.

Z. E. Lako: Kam diçka për zotin Kaziaj në vijim të asaj që tha edhe përfaqësuesi i PDIU-së që të kuptojmë më mirë se cila është lidhja ndërmjet përkatësisë së deputetëve, ashtu siç janë përcaktuar nga vendimi i KQZ-së me pjesëmarrjen ose jo në grupin parlamentar, pasi në dijeninë time një grup parlamentar nuk mund të jetë, për shembull, në rastin konkret i përbërë nga tre anëtarë. Është 7 anëtarë për të bërë një grup, pra, fakti që këta nuk janë pjesë e një grupi tregon që këta nuk janë pjesë e PDIU-së apo nuk janë pjesë e opozitës apo të gjithë deputetët e Kuvendit aktual janë pjesë e grupeve parlamentare, apo ata që nuk janë pjesë e grupeve, janë pjesë e pozitës? Në sqarim për sa i përket kësaj.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Lako! Po të shihni të gjithë praktikën të sjellë nga ana e Kuvendit, ka të bëjë me orientimin dhe përkatësinë në vetvete. Pse nuk janë vetidentifikuar nëpërmjet deklaratës këta deputetë? Nuk ka lidhje me grup parlamentar apo jo. Grupi parlamentar formohet nga 7 deputetë, nuk ka lidhje me ato që mund të jenë interesa të brendshme aty, por në deklaratë nuk flitet në

25

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

vetvete vetëm për grupin, por edhe për partinë, kështu që nuk janë identifikuar si të partisë të subjektit të tyre për të cilin janë zgjedhur, kjo është fare e qartë.

Z. Sh. Sulo: Pyetjet janë shumë të qarta nga anëtarët e KAS-it. Normalisht kërkohet që të devijohet. Lexohet neni 183, pika 8, dhe nuk lexohet si është, sqarohet edhe nga kolegu se cilat janë deklarimet apo grupet parlamentare. Në ankimin e bërë thuhet se çfarë qëndrimi mban PDIU-ja sot. Ky është kontestimi që kapim mat. Atë e ka sqaruar neni 183 dhe momenti se kur quhesh pozitë parlamentare ose opozitë parlamentare, të cilat unë i shpjegova. Neni 15, neni 34 i ka fare të qartë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nga kolegët nuk ka. Atëherë do t'jua jap edhe një herë fjalën sipas radhës për konkluzionet e fundit, shkurtimisht ju lutem.

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për përfaqësuesin e PDIU-së. Sot që flasim mund të na sqaroni se në çfarë pozitash është PDIU-ja, është me opozitën apo me maxhorancën, pavarësisht si e interpretoni ju nenin e Kodit Zgjedhor, nenin 183. Në qoftë se flasim për situatën aktuale, PDIU-ja sot është me maxhorancën apo me opozitën.

Z. Sh. Sulo: Faleminderit! Sot PDIU-ja është në opozitë, shkresë, e cila i është drejtuar edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në fazën që ne ishim duke shqyrtuar këtë projektvendim, për sa i përket grupit të numërimit. Kalimi në pozitën parlamentare dihet fare qartë që bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje, bëhet

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

publike. Ne shprehëm edhe qëndrimet dhe votimet që janë bërë nga përfaqësuesit e PDIU-së, pavarësisht se këtu nga pala tjetër u tha që kemi disa votime. Cilat ishin votimet? Ne e kemi fare të qartë. Unë nuk e di që ne jetojmë këtu e themi që PDIU është në pozitë parlamentare, është me qeverinë. Është fare e qartë, i nderuar anëtar, që është pjesë e opozitës shqiptare. Është një shkresë e sjellë nga kryetari i PDIU-së, e depozituar pranë institucionit të KQZ-së.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Rimarrim konkluzionet duke filluar nga zoti Kaziaj.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti relator! Për sa i përket qëndrimit tonë tashmë ju e keni të qartë dhe pas debatit këtu në këtë komision. Janë elemente të mjaftueshme për të arritur në konkluzion që ju me integritet ta pranoni kërkesën ankimore duke ndryshuar si përfundim atë që është vendimi nr. 404, datë 24.4.2023 dhe duhet caktuar në këtë rast sipas frymës së ligjit Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta për propozimin e katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 për argumentet që unë citova në relatin tim.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Përfaqësuesi i PDIU-së.

Z. Sh. Sulo: Duke iu referuar fakteve të ankimit, referuar kontestimeve dhe parashtrimeve që ne paraqitëm, referuar edhe përgjigjeve që u bënë në këtë seancë publike edhe nga anëtarët e KAS-it, rezultoi që ankimi i paraqitur kishte natyrë politike dhe jo natyrë ligjore, shumë e qartë. Vendimi i miratuar nga Komisioneri

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Shtetëror të Zgjedhjeve është konform Kushtetutës, Kodit Zgjedhor, neneve 95, 96, nenit 183, pika 8. Ne kërkojmë mospranimin e ankimit, lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit sipas shortit të paraqitur në këtë vendim. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Rrëzimin e ankimit të Partisë së Lirisë, një ankim pa argument ligjor dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 404, datë 24.4.2023. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për t'u këshilluar e diskutuar për çështjen. Do të na duhen rreth 30 minuta, kështu që paraprakisht po e lëmë të ritakohemi këtu për shpalljen e vendimit në orën 14.00. Në qoftë se do të kemi nevojë për pak më tepër kohë, do t'ju njoftojmë. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 14:11

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve edhe një herë! Atëherë, KAS-i, pasi diskutoi çështjen në tërësi, vendosi rrëzimin e ankimit për shkak të mungesës së numrit të kërkuar të votave për vendimmarrje. Besoj se e keni në konsideratë pikën 3 të nenit

***Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

21 të Kodit Zgjedhor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 71

*Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.2.05.2023*

**02.05.2023
Ora 14:13**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 16 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve me objekt “Vendosje sanksioni administrativ”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Të tjerë: KRIIK, OSBE/ODHIR

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për shqyrtimin me themel të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me numër 16, datë 26.04.2023, për vendosje sanksioni administrativ kundrejt personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Prefekturën e Qarkut Korçë, kundrejt personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Belsh, kundrejt personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Gjirokastrë, kundrejt personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kavajë. Nga Komisioneri i është propozuar KAS-it vendosja e sanksionit administrativ për të gjithë personat e sipërcituar gjombë në masën 5000 lekë. Sikurse jeni në dijeni tashmë, për këtë çështje jam caktuar relator unë, anëtari Elis Çefa, verifikojmë prezencën. Është prezent trupa e KAS-it në përbërje të katër anëtarëve, pra nuk ka pengesë ligjore për vijimin e kësaj séance dhe marrjen e një vendimi në këtë rast, po ashtu është prezent Sekretari i Përgjithshëm, i cili në këtë procedurë administrative do të përfaqësojë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administrata shoqëruese e Sekretarit të Përgjithshëm. Nuk shoh që ka kërkesë apo që ka prezencë të personave

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.2.05.2023*

të interesuar, besoj nga administrata janë njoftuar rregullisht për datën dhe orën e zhvillimit të seancës.

Z. Y. Merkaj: Po, po.

Z. E. Çefa: Dakord atëhere nuk kemi pengesë për të vazhduar shkurtimisht me relatimin, që do të ftoj të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, të kërkesës së Komisionerit, zoti Merkaj fjala është për ju.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicje për organizimin e veprimtarive publike, nga katër institucioneve publike, nga të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar në faqen e KQZ-së për këtë qëllim. Denoncimet janë marrë nepërmjet provave të radministruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dhe konkretisht është marrë një denoncim me ID 250, ku pretendohet se Prefekti i Qarkut Korçë, ka organizuar takim me studentët e universitetit Fan Noli, i cili rezulton të jetë i pa raportuar, nga hetimi administrativ ka rezultuar se Prefekti i Qarkut Korçë ka organizuar një takim me studentët e universitetit Fan Noli dhe kjo veprimtari publike nuk është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Detyrimi për këtë është i personit përgjegjës që ka pasur detyrimin për ta raportuar në këto kushte përderisa nuk i ka raportuar në referencë të pikës 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri duke e konsideruar që është veprimtari publike që duhet raportuar, i ka propozuar KAS-it vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5000 lekë. Gjithashtu dhe për Bashkinë Belsh, janë organizuar tre veprimtari të regjistruara me ID 258, 259 dhe 260, ku personi përgjegjës për raportimet në Bashkinë Belsh ka qënë i detyruar t'i raportonte këto në faqen e KQZ-së, nuk i ka raportuar, janë aktivitete që janë zhvilluar në ambiente

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.2.05.2023*

të lokaleve të ndryshme, janë konsideruar gjatë hetimit administrativ si veprimtari publike, dhe në këto kushte duke qënë se personi përgjegjës nuk ka përmbushur detyrimin për raportimin në faqen e KQZ-së, Komisioneri në referencë të nenit 171, pika1, të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve me kërkesën për vendosjen e sanksioneve administrativë ndaj personit përgjegjës të Bashkisë Belsh, në masën 5000 lekë. Gjithashtu kemi dhe Bashkinë Gjirokastrë, e cila ka kryer katër veprimtari publike për të cilat personi përgjegjës i Bashkisë Gjirokastrë nuk i ka raportuar, gjithashtu gjatë komunikimit me personin përgjegjës nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për të dhënë një informacion të detajuar, në këto kushte Komisioneri duke qënë se gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se këto janë veprimtari publike që duhet të ishin raportuar dhe nuk janë raportuar i ka kërkuar KAS-it, vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5000 lekë për personin përgjegjës të Bashkisë Gjirokastrë. Në të njëjtën situatë jemi dhe në Bashkinë Kavajë ku janë zhvilluar dy aktivitete publike, personi përgjegjës nuk i ka raportuar këto, ka patur detyrimin t'i raportojë, në këto kushte gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se vetëm një veprimtari publike duhet të ishte raportuar, nuk është raportuar, në këto kushte edhe për personin përgjegjës të Bashkisë Kavajë është bërë propozimi për vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5000 lekë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj! Pyetje nga kolegët? Nuk ka, dakord, unë thjesht kam një pyetje në fakt që e kam bërë edhe herë të tjera, që është më shumë forma e konstatimit, shoh reagim të ndryshëm të subjekteve kundrejt kërkesës për llogari të komisionerit. Pra kur Komisioneri kërkon shpjegime dhe kur shoh që subjekti i detyruar për të deklaruar as nuk denjon as të kthejë përgjigje, në opinionin tim përrsonal meriton një masë ndëshkimore më të rëndë. Sigurisht jo për shkak të masës në vetvete apo të ndëshkimit në vetvete, po për efekt të përcimit të mesazhit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.2.05.2023*

të edukimit zyrtarë të atyre personave, të cilët përveçse nuk kanë raportuar veprimtari që me ligj janë të detyruar, nuk kanë konsideruar të arsyeshme as të sqarojnë as arsytet pse nuk e kanë bërë këtë. Megjithatë kjo sigurisht nuk përbën po themi asnjë arsye nga unë që të mos pranoj, por jo, pyetja konsiston, pse nga Komisioneri nuk është bërë një përshkallëzim i masave administrative në proporcion gjithmonë me gravitetin po themi të shkeljes. Po ashtu janë barazuar dhe rastet kur janë konstatuar tre veprimtari të raportuara me rastin ku është konstatuar vetëm një veprimtari e raportuar. Pra pse nuk është bërë një farë, dhe a mund të bëhet një farë përshkallëzimi.

Z. I. Ruzmajli: Edhe një shtesë, pse nuk ka procedim administrativ për refuzim për bashkëpunim.

Z. Y. Merkaj: Përsa i përket pyetjes së parë që bëri relatori i çështjes, mendoj që Komisioneri do ketë pasur parasysh dhe parimin e kofidencialitetit, duke qënë se nuk janë përsëritës ka menduar se panvarësisht se nuk i kanë kthyer përgjigje kërkesës së KQZ-së, është menduar të vendoset një masë afër minimumit. Për pjesën tjetër të mosbashkëpunimit besoj që nuk ka patur indicjet, ose nuk ka qënë reagimi kaq i ashpër që të vazhdonim edhe të ashpërshej edhe masa e dënimit ose kërkesa për propozim vendosje sanksioni.

Z. E. Çefa: Dakord, atëhere pyetje të tjera nuk ka, përfundimisht zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Kërkojmë pranimin e kërkesës së Komisionerit, duke vendosur sipas propozimit masën administrative për personin përgjegjës të Bashkisë Gjirokastrë,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.2.05.2023*

Kavajë, Belsh dhe Përfekturën e Qarkut Korçë, me masën që ka propozuar Komisioneri 5000 lekë. Faleminderit.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, atëhere ne do tërhiqemi për një vendim, duam 5 minuta kohë me mirëkuptimin tuaj dhe do t'ju ftojme, domethënë mbas 5 minutave ju konsiderojeni derën hapur hyni vet, që ne ta shpallim, faleminderit.

Rifillon seanca

Ora 14:30

Z. E. Çefa: Mirëdita dhe njëherë, atëhere KAS pasi diskutoi çështjen në tërësi vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit me numër 16 për vendosjen e sanksionit administrativ kundrejt personave përgjegjës të cituar në këtë kërkesë. Vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 5000 lekë ndaj zonjës Ormela Bena, për person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë. Vendosjen e masës administrative gjorbë në shumën 7000 lekë ndaj zotit Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Belsh. Vendosjen e masës administrative gjorbë në masën 10000 lekë kundrejt zotit Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Gjirokastrë. Dhe vendosjen e masës administrative gjorbë në shumën 5000 lekë kundrejt zotit Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Kavajë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së, kundrejt këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë sipas ligjit. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 72

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

02.05.2023

Ora 14:31

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 17 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve me objekt “Vendosje sanksioni administrativ”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Të tjerë: KRIIK, OSBE/ODHIR

Z. L. Braho: Përshëndetje të gjithëve, çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 17. Kërkesa e Komisionerit është inicjuar në bazë të denoncimit, të dy denoncimeve dhe ka të bëjë me Bashkinë Korçë, Komisioneri ka kërkuar që të vendoset gjobë ndaj zotit Sotiraq Fili në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe zonjës Marjana jorgji, në cilësinë e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Korçë, dhe ndaj zotit Luis Qyrynxhi, administrator i Qendrës Sportive Korçë SH.A. të pranishëm janë njoftuar palët në lidhje me shqyrtimin administrativ?

Z. Y. Merkaj: Janë njoftuar.

Z. L. Braho: Janë njoftuar dhe nuk është i pranishëm asnjë prej palëve ndaj të cilëve kërkohet vendosja e sanksionit administrativ. Të pranishëm është administrata e

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm zoti Ylli Merkaj. Ka pretendime ndonjë nga anëtarët e KAS-it në lidhje me konfliktin e interesit me personat që citova? Jo. Atëhere trupa e KAS-it përbëhet nga katër anëtarë, një nga anëtarët mungon për shkaqe objektive dhe duke qënë që plotësohet kuota në bazë të ligjit edhe mund ta gjykojmë sot këtë çështje. Fjala është për Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, të bëj një relativim në lidhje me kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë administruar dy denoncime dhe një raport monitorimi tek të cilat denoncohet zhvillimi i një aktivitetit të vlerësuar si i ndaluar nga KQZ-ja, për Bashkinë Korçë. Denoncimet janë administruar me shkresat përkatëse. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se Kryetari i Bashkisë Korçë, më datën 31 mars 2023, ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së një veprimtari publike me objekt takim prezantues me asamblenë e zgjeruar, raportuar me datën 31 mars për t'u zhvilluar me datën 1 prill 2023 ora 11.00, vëndi i zhvillimit Korçë, me folës kryesor zotin Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë, pjesëmarrësi i deleguar politik i qarkut Niko Peleshi, anëtar të asamblesë së zgjeruar, deputetë të Qarkut Korçë, pjesëmarrës të tjerë. Në orën 19.00 të së njëjtës ditë, me vendimin numër 231, të komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është vendosur ndalimi i zhvillimit të kësaj veprimtarie. Panvarësisht ndalimit nga KQZ-ja të këtij aktiviteti, sërisht ai është mbajtur në ambjentet e Qendrës Sportive Korçë, me vendndodhje në rrugën Nika Kovaçi, pranë Qytezës së Fëmijëve dhe duke qënë se ky aktivitet është mbajtur në këtë ambient, kjo përbën edhe një shpërdorim të burimeve publike. Gjatë hetimit administrativ i është kërkuar komunikim me personin përgjegjës të raportimeve dhe në datën 6.04.2023, nëpërmjet postës elektronike, përgjegjësi për raportimet pranë Bashkisë Korçë i ka dërguar

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

informacion KQZ-së ku bën me dije se Kryetari i Bashkisë Korçë është informuar në lidhje me vendimin 231, datë 31 mars 2023, për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të bashkisë Korçë, të KQZ-së dhe bashkia nuk ka zhvilluar asnjë veprimtari, pretendon personi raportues, asnjë veprimtari të ndaluar nga Komisioni Zgjedhor. Veprimtaria është zhvilluar nga Partia Socialiste ku kryetari ka marrë pjesë si i ftuar në cilësinë e koordinatorit të kryetarëve të bashkive. Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka konstatuar se aktiviteti i mësipërm është aktivitet politik dhe Bashkia Korçë ka gabuar në raportimin e këtij aktiviteti. Aktiviteti ka pasur për objekt takim prezantues me asambenë e zgjeruar dhe është raportuar në ndërfaqen në datë 31 mars 2023, për tu organizuar në datë 1 prill 2023. Gjatë hetimit administrativ është vërejtur se pas daljes së vendimit për ndalim të zhvillimit të aktivitetit nga Komisioni qendror i Zgjedhjeve, Bashkia Korçë dhe pse ka pasur dijeni për këtë ndalim nuk ka ndërmarrë asnjë veprim përmbi ankimimin apo vënien në dijeni të Komisionit qendror të Zgjedhjeve, mbi organizimin e aktivitetit të planifikuar për t'u zhvilluar. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve rezulton se zoti Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë Korçë ka zhvilluar aktivitet të ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve panvarësisht marrjes në dijeni për ndalimin e këtij aktiviteti. Pëesa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar dhe provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se zhvillimi i këtij aktiviteti të ndaluar për tu planifikuar nga Bashkia Korçë, përbën shkelje të nenit 92, të kodit Zgjedhor dhe vendimit numër 9 të vitit 2020, të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri ka propozuar KAS-it vendosjen e sanksionit administrativ për Kryetarin e Bashkisë Korçë në masën 10000 lekë dhe personit përgjegjës për raportimet e veprimtarive të ndaluara publike të Bashkisë Korçë, gjobë në masën 5000 lekë. Bashkëlidhur kemi gjithë faktet. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaj, ndonjë pyetje nga kolegu? Unë kisha një pyetje në fakt. Ju cituat që pas zhvillimit të veprimtarisë, Bashkia Korçë me shkresa ka pretenduar se nuk është ajo organizatore e aktivitetit, por është Partia Socialiste. Ka ndonjë provë ku bazohet ky pretendim?

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi provë që e ka organizuar Partia Socialiste, por gjatë hetimit ka dalë që ka qënë Bashkia Korçë ajo që ka organizuar këtë takim.

Z. L. Braho: Faleminderit! Dakord, nëqoftëse nuk ka pyetje të tjera, KAS do të tërhiqet 5 minuta për vendim, dhe ora është 14:40, në ora 14:45 shpallim vendimin.

Rifillon seanca

Ora 15:30

Z. L. Braho: Atëhere çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 17. KAS pasi u tërhoq për vendim, bazuar në të gjitha provat e depozituara dhe në parastrimet e përfaqësuesit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendosi rrëzimin e kërkesës së Komisionerit me numër 17, të datës 26.04.2023, për vendosjen e sanksionit administrativ dhe arsyetimi me të cilin arritëm në këtë përfundim kemi të bëjmë me faktin se kemi të bëjmë me një aktivitet që është aktivitet politik i organizuar nga një parti politike, panvarësisht raportimit që është bërë nga Bashkia Korçë, dukesh që është bërë një raportim për pjesëmarrje në aktivitet dhe jo për organizim aktiviteti. Nuk mundet që Bashkia Korçë të zhvillojë aktivitet, ose më saktë të organizojë aktivitet për asamblenë e zgjeruar të Partisë Socialiste, ku prezantohet kandidati për kryetar bashkie, ndaj edhe

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

raportimin edhe ndalimin i konsiderojmë si në lajthitje të ligjit, le të themi. Po ashtu ka dhe një faturë që është paraqitur, dhe nga fatura rezulton që shitës është Qendra Sportive Korçë ndërkohë që blerës nuk është Bashkia Korçë, por është një individ me emër, mbiemër që besoj duhet të ketë paguar për Partinë Socialiste qeranë e ambienteve ku është organizuar asambleja e zgjeruar e Partisë Socialiste, ndaj në këto kushte KAS nuk mund të vendos sanksione administrative për organizimin e aktiviteteve politike partiake, por patjetër nëqoftë se do të vërtetohej që ky do të ishte organizuar nga Bashkia Korçë, patjetër që do të kishim vendosur sanksion administrativ. Por logjika normale e kujtdo na bën të mendojmë që nuk mund të jetë aktivitet i organizuar nga Bashkia Korçë. Kaq sa i përket kësaj kërkesë të Komisionerit. E deklarojmë seancën të mbyllur.

Vendimi nr. 73

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

02.05.2023

Ora 15:04

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës nr. 15 të Komisionerit
Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Vendosje sanksioni administrativ”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmani, Z. E. Mema
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE ODIHR

Z. I. Rusmali: Përshëndetje, çelim shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit numër 15, me objekt vendosje sanksioni administrativ ndaj personave përgjegjës për rapostimin. Zonja Orieta Kurti, person përgjegjës për raportimin Bashkinë Dibër. Zoti Bajram Pishkashi, person përgjegjës për raportimin në Bashkinë Librazhd. Zonja Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportin në Bashkinë Lushnje. Zoti Nuri Belba, Kryetar i Bashkisë Përrenjas.

Prezenca e palëve në seancë, janë prezent ekipi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm zotit Merkaj. Palët janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës përgatitore dhe seancës së themelit eventualisht dhe nuk janë prezent. Trupa e KAS-it është e përbërë nga katër anëtarët, kolegu ynë Koli Bele ne mungesë me shkaqë të justifikuara. Kërkesa paraprake Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka çfarë të ketë. Mirë, zoti Merkaj mund të na trajtoni çështjet e formës për këtë kërkesë?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncim për organizimin e katër veprimtarive publike nga katër institucione publike për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91, 92 të Kodit Zgjedhor. Referuar edhe Kodit Zgjedhor Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka filluar hetimin administrativ për të katër këto veprimtari publike, ku në përfundim të hetimit administrativ është konstatuar se është shkelur neni 91 dhe 92 i Kodit Zgjedhor. Konkretisht është raportuar pjesërisht për një veprimtari, për veprimtarinë tjetër nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike burime të organeve dhe enteve publike, shpërdorim të burimeve shtetërore. Në këto kushte Komisioneri ka arritur në konkluzionin, duke qenë se janë shkelur neni 91 dhe 92 i Kodit Zgjedhor i ka propozuar KAS-it vendosjen e masave administrative për personat përgjegjës dhe konkretisht: Kryetarin e Bashkisë Përrenjas në masën 10,000 lek, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Dibër me gjobë në masën 5,000 lek, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Librazhd gjobë në masën 5,000 lek dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Lushnje në masen 5,000 lek. Në këto kushte përkojmë që të merret në konsideratë kërkesa e Komisionerit për vendosjen e masave administrative ndaj këtyre personave, faleminderit.

Z. I. Rusmali: Dakord, kërkesa e Komisionerit bazohet në të drejtën e tij ligjore për të zhvilluar hetimin e shkeljeve dhe për ti kërkuar KAS-it çdo rast kur ai e gjykon të arsyeshme marrjen e masave administrative. Shqyrtimi i çështjes nga KAS-i mbështetet në kompetencën e KAS-it për të vendosur masat administrative, kështu që ne nuk kemi asnjë dilemë lidhur me çështjet e formës, lidhur me te drejtën për të vënë në lëvizje KAS-in për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Prandaj

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Komisioni i konsultuar në vend vendos pranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë dhe zhvillimin e seancës së shqyrtimit në themel menjëherë pas mbylljes së kësaj seance. Me këtë deklaram vendimi e mbyllim seancën paraprake dhe përgatitemi për zhvillimin e seancës së themelit.

Vendimi nr. 74

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

**02.05.2023
Ora 15:09**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 15 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve me objekt “Vendosje sanksioni administrativ”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmani, Z. E. Mema
- **Të tjerë:** **KRIIK, OSBE ODIHR**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës numër 15 të Komisionerit, me objekt vendosje sanksioni administrativ ndaj subjekteve të cituara pak më parë në seancën paraprake. Prezenca e palëve siç ishte në seancën paraprake. Proceduralisht gjithçka në rregull për vazhdimin e seancës. Kërkesa paraprake nga palët nuk ka, deklarime nga anëtarët e Komisionit nuk ka. Sekretari i Përgjithshëm i qëndron prezantimit të kërkesës siç u bë në seancën paraprake, pa patur nevojë ta përsërisim, apo jo?

Z. Y. Merkaj: Po, i qëndrojmë kërkesës.

Z. I. Rusmali: Pyetje nga kolegët për ndonjë nga çështjet? Dakord!

Kam unë një pyetje për pikën e dytë të kërkesës, lidhur me Bashkinë Përrenjas. Siç shpjegohet nga shtjellimi i bërë, këtu duket sikur bëhet fjalë për një inspektim për rehabilitimin e një rruge në fshatin Rashtan, jemi këtu në këtë rast në kushtet e përdorimit të aseteve publike siç përcakton vendimi numër 9 i Komisionit

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Rregullator? Më konkretisht keni investiguar fondin e vënë në dispozicion për këtë investim? Është fond në kushtet e parashikuara nga vendimi numër 9? Apo nuk jemi përpara këtij rasti shpërdorimi?

Z. Y. Merkaj: Nuk jemi përpara këtij rasti shpërdorimi.

Z. I. Rusmali: Cili është rasti?

Z. Y. Merkaj: Kryetari i bashkisë duke qenë dhe kandidat për kryetar bashkie aktual ka bërë një takim elektoral me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të qarkut. Ku dhe ka bërë fushatë elektorale në fshatrat ku ka qenë, Rashtan, Karkavec, Golem, Pishkash. Ka bërë premtime elektorale kështu që për këto arsye kemi vendosur edhe gjobën.

Z. I. Rusmali: Po kush janë asetet e shpërdoruara në këtë rast? Sepse ne na duhet të identifikojmë asetet e shpërdoruara për të shkuar tek përgjegjësia.

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi shpërdorim asetesh, thjesht vetëm pjesëmarrja.

Z. I. Rusmali: Thjesht zhvillimin e një veprimtarie me karakter elektoral...

Z. Y. Merkaj: Të kandidatit për kryetar bashkie dhe kryetarit të bashkisë, aktual.

Z. I. Rusmali: Dakord! Lidhur me çështjen e parë që ka lidhje me denoncimin numër 221, Bashkia Librazhd. Juve ju ka ardhur një denoncim nga një organizatë e shoqërisë civile e cila (siç e lexoj unë) konstaton parregullsi në raportimin e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

institucionit, bashkisë. Gjithashtu konstaton që lidhur me këtë veprimtari publike, konkrete është përdorur për promovimin e saj faqja zyrtare e bashkisë dhe veprimtaria është zhvilluar në mjediset e një shkolle 9 – vjeçare. Në fund Komisioneri ka dalë në konkluzionin që duhet vendosur gjobë administrative për mosraportim të rregullt. Këto elementët e tjerë të denoncimit me çfarë arsytimi i keni rrëzuar?

Z. Y. Merkaj: Sepse në raportim është njoftuar që do të bëhet inspektim punimesh, në fakt nga postimi në video konstatohet se nuk është inspektim punimesh por është promovim i investimit të përfunduar tashmë madje edhe në efikasitet të plotë. Duke qenë se pika 4 e nenit 4, të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator thotë që “ edhe nëqoftëse nuk është raportuar ose raportohet pjesërisht atëhere kjo quhet shkelje e vendimit numër 9”.

Z. I. Rusmali: Dakord, por denoncuesi pretendon që përdorimi për këto qëllime i faqës zyrtare (pra për qëllimet elektorale) e cila në vlerësimin e denoncuesit është aset publik, formon shkelje. Sikurse zhvillimi i veprimtarive politike, elektorale në mjedise që janë asete publike si shkollat 9 – vjeçare formon shkelje gjithashtu.

Z. Y. Merkaj: Pretendimi është pretendim dhe jo gjithmonë duhet të jetë i vërtetë. Komisioni ka konstatuar që nuk është i vërtetë ose nuk është vërtetuar ky pretendim por ka provuar që ky është një raportim i pjesshëm.

Z. I. Rusmali: Mirë. Pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka pyetje! Kërkesa juaj përfundimtare cila është?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëherë kërkesa jonë është pranimi i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vendosi e sanksioneve administrative sipas kërkesës për personat përgjegjës, Kryetarin e Bashkisë Përrenjas në masën 10,000 lek, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Dibër me gjobë në masën 5,000 lek, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Librazhd gjobë në masën 5,000 lek dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Lushnje në masen 5,000 lek. Faleminderit.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit. Mbylлим ketu diskutimin për këtë çështje dhe tërhiqemi për marrjen e vendimit. Vendimin do ta shpallim, besoj për 5 minuta. Pas 5 minutave takohemi.

Rifillon mbledhja

Ora 15:23

Z. I. Rusmali: Mirë atëhere, riçelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS-i pasi dëgjoji pretendimet e paraqitura dhe shqyrtoi provat që kishte në dispozicion vendosi:

- Pranimin e pjeshëm të kërkesës së Komisionerit.
- Rrëzimin e masës administrative me gjobë ndaj zotit Nuri Belba, Kryetar i Bashkisë Përrenjas për shkak të mungesës së numrit të plotë të votave për vendimmarrje dhe pranimin e kërkesës së Komisionerit për subjektet e tjera të kërkuara në kërkesë.
- Vendosi e marrjes së masës administrative ndaj zonjës Orieta Kurti person përgjegjës për raportimin në Bashkinë Dibër dhe vendosjen e gjobës në masën 5,000 lek.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.05.2023*

- Marrjen e masës administrative ndaj zotit Bajram Pishkashi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Librazhd dhe vendosjen e gjobës në masën 5,000 lek.
- Marrjen e masës administrative ndaj zonjës Erisa Qalliu person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Lushnje, vendosjen e gjobës në masën 5,000 lek.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi subjektet e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi. Me kaq e mbyllim seancën për shqyrtimin e kësaj kërkesë, faleminderit.

Vendimi nr. 75

*Zbardhi materialin audio
Jong DERVISHI*

